

Zyra e Zyqruer për mbikq. financ. Cancel Zm. qruer za financ. nadz. Office of Vice-gover for financ. superv.	
Primit Priglas and of	Nr. 202/1801
Forward To	NK

KOSOVO INSURANCE BUREAU - NIB  
 Nr. 144/12, Dt. 30.10.2012  
 PRISHTINE

NATIONAL INSURANCE BUREAU  
 Бр. 0110-2490/12  
 24.10. 2012 год.  
 СКОПЈЕ - SKOPJE

**MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT**

Ndërmjet Byrosë Nacionale të Maqedonisë (NIB) dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS) si entitete të autorizuara përgjegjëse për çështjet e sigurimit nga autopërgjegjësia në Republikën e Maqedonisë dhe Republikën e Kosovës në Njohjen Reciproke të Sigurimit nga Autopërgjegjësia për Palët e Treta (TPL) dhe procedurat e procesimit dhe trajtimit të dëmeve.

Duke pasur parasysh që:

NIB dhe BKS ("Palët") dëshirojnë të formojnë kornizën për:

- a) marrëveshjet për njohjen reciproke të policave valide të sigurimit të autopërgjegjësisë nga palët e treta TPL dhe/ose Kartonit të Gjellbër ndërkombëtar valid, si vërtetim për sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësisë në palës së tretë TPL, dhe
- b) marrëveshjet mbi trajtimin dhe pagesës së dëmeve si pasojë e aksidenteve të shkaktuara nga automjetet e siguruar në R. e Kosovës dhe R. Maqedonisë.

Palët janë pajtuar si në vijim:

**I. DEFINICIONET**

Për qëllimet e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MOU):

"BKS" nënkupton Byronë Kosovare të Sigurimit

"NIB" nënkupton Byroja Nacionale e Maqedonisë

"Fondi Garantues" është fondi i themeluar ligjërish, dhe i administruar nga BKS në Kosovë, respektivisht nga NIB në Maqedoni.

"Byroja për trajtime" është pala, qoftë ajo NIB, BKS apo anëtarët e saj të autorizuar-kompani e sigurimeve ose ndonjë entitet tjetër ligjor, cila trajton dhe kompenzon dëmet sipas dispozitave të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit dhe e cila kërkon kompenzim nga Anëtari Sigurues apo nëpërmes të Byrosë së Pagesave, në bazë të kushteve të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit.

"Anëtari sigurues" nënkupton kompaninë e licencuar të sigurimit, e cila është anëtare e NIB-së ose BKS-së, dhe të cilat kanë siguruar automjetin i cili ka shkaktuar aksidentin në fjalë, me anë të polisës së sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësisë apo Kartonit të Gjellbër.



“Byroja e pagesave” është byroja, qoftë NIB apo BKS, që është përgjegjëse për rimbursimin e dëmeve, të paguara nga Byroja për Trajtim, në pajtim me procedurat e këtij Memorandumi, që mëpastaj do t'i kompenzohet nga Anëtari sigurues.

“Vërtetimi mbi sigurimin” do të thotë ekzistenca e Çertifikatës valide TPL Plus të sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësish, për automjetet e regjistruara në Kosovë, të lëshuar nga Anëtari Sigurues në Kosovë, në rast të aksidenteve që ndodhin në Maqedoni, ose Kartonin e Gjellbër valid të NIB, për automjetet e regjistruara në Maqedoni, të lëshuar nga Anëtari Sigurues në Maqedoni, për aksidentet që ndodhin në Kosovë.

“Rregullorja e Brendshme” është Rregullorja e Brendshme e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Këshillit të Byrove, në Kretë më 30 Maj 2002, e reviduar me vendimet e posaçme të inkooporuara në Memorandumin Sqarues.

“Korrespondent” – nënkupton çdo kompani të sigurimeve – anëtare e NIB ose BKS ose çdo kompani e autorizuar për vlerësimin e dëmeve, e emëruar nga Byroja Paguese sipas kërkesës nga një apo më shumë anëtarë – kompani të sigurimeve me konfirmimin e palës siguroese ose një kompanie të themeluar dhe autorizuar për trajtimin dhe pagesën e dëmeve nga TPL. Definicionet, emërimet, autorizimet dhe trajtimi i dëmeve nga korrespondentët do të jetë në pajtim me standardet e themeluara sipas Rregullores së Brendshme të Këshillit të Byrove në Bruksel.

## II. NJOHJA RECIPROKE E PËRGJEGJËSISË SIGURUESE TË MJETEVE MOTORIKE

1. Shfrytëzuesit e automjeteve motorike të regjistruara në R. e Kosovës, të cilat posedojnë polisën valide të sigurimit TPL Plus të Kosovës, mund të hyjnë lirisht dhe të udhetojnë në Maqedoni. Kopja e mostrës së polisës TPL valide të sigurimit Plus të Kosovës i është bashkangjitur këtij Memorandumi si Shtojca I.
2. Shfrytëzuesit e automjeteve motorike të regjistruara në Maqedoni, të cilat posedojnë Kartonin e Gjellbër ndërkombëtar valid të lëshuar nga autoriteti i NIB, mund të hyjnë lirisht dhe të udhetojnë nëpër Kosovë. Kopja e mostrës së Kartonit të Gjellbër ndërkombëtar të Maqedonisë, i është bashkangjitur këtij Memorandumi si Shtojca II.
3. Secila palë duhet t'ia jap palës tjetër, listën ku përfshihen emrat e të gjithë Anëtarëve Sigurues, në ditën e nënshkrimit të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, dhe për çfardo ndryshimi duhet të njoftoj palën tjetër brenda 15 ditëve nga vënia në dijeni për këtë ndryshim.



4. Palët pajtohen që secili Karton i Gjellbër për të cilin supozohet se është lëshuar nga autoriteti i NIB, për automjetet e regjistruara në R. e Maqedonisë dhe për të cilin supozohet se është kompletuar si duhet për përdorim në Kosovë, apo secila Çertifikatë e polisës TPL Plus të Kosovës, për të cilën besohet se është lëshuar në Kosovë, për automjetet e regjistruara në Kosovë dhe e cila është e kompletuar si duhet për përdorim në R. e Maqedonisë, do të konsiderohet si dëshmi valide e sigurimit, në pajtim me Rregulloren e Brendshme (Marrëveshja e Kretës).

5. palët kontraktuese pajtohen që çdo certificate e sigurimit e cila supozohet të jetë lëshuar nga njëri nga anëtarët e Byrosë, sipas autorizimit të tyre, do të konsiderohet prove valide e sigurimit, edhe nëse është e falsifikuar, e paautorizuar ose e ndryshuar në mënyrë ilegale – në pajtim me nenin 9 të Rregullores së Brendshme.

### III. TRAJTIMI DHE PAGESA E KËRKESAVE PËR ZHDËMTIM

1. Secila palë do të trajtoj dhe të paguaj kërkesat për zhdëmtim që i janë adresuar nga pala tjetër apo drejtëpërdrejt nga paraqitësi i kërkesës për zhdëmtim, brenda autorizimeve të MOU, në pajtim me Nenin IV të kësaj MOU, dhe në baza të njëjta siç trajton dhe paguan kërkesat për zhdëmtim të paraqitura nga personat e siguruar brenda jurisdiksionit përkatës të tyre.

2. Me këtë Memorandum të Mirëkuptimit, përfshihet raportimi, trajtimi dhe pagesa e kërkesave për zhdëmtim në rast të lëndimeve personale si dhe për humbje apo dëmtim të pasurisë:

(a) që kanë ndodhur si pasojë e ndonjë aksidenti në R. e Maqedonisë, të shkaktuar nga automjetet e regjistruara dhe të siguruar në Kosovë, të cilat posedojnë polisën e sigurimit të detyruar të autopërgjegjësishë TPL, si dëshmi e ekzistimit të sigurimit, ose

(b) që kanë ndodhur si pasojë e ndonjë aksidenti në Kosovë, të shkaktuar nga automjetet e regjistruara dhe të siguruar në R. e Maqedonisë, të cilat posedojnë Kartonin e Gjellbër valid të NIB.

3. Në rast të aksidentit, Byroja për Trajtime, është e obliguar që menjëherë të njoftoj Byronë për Pagesa, për çfardo kërkesë për zhdëmtim, dhe duhet të veprojnë në interesin e Byrosë për Pagesa sikur vetë të kishte lëshuar Dëshminë e sigurimit.

4. Pasi që të paguhet kompensimi, Byroja Trajtuese, është e obliguar t'i dërgoj Byrosë për Pagesa, të gjitha dokumentet e nevojshme për të justifikuar pagesën, duke përfshirë edhe raportin e policisë, i cili përmbanë të dhënat mbi pjesëmarrësit në aksidentin e tillë, fotografitë e automjetit të dëmtuar, ekspertizën profesionale në vlerësimin e dëmit, si dhe Çertifikatën e Sigurimit apo, kur kjo nuk është e mundur, numrin e polisës së



sigurimit dhe afatin e sigurimit, emrin e Anëtarit Sigurues, së bashku me konfirmimin mbi sigurimin si dhe " Formularin mbi pagesën", ku evidentohet kompensimi i pjesërishëm apo i tërësishëm i dëmit.

#### IV. RIMBURSIMI

1. Byroja për Pagesa e secilës palë, është e obliguar t'ia kompensoj Byrosë për Trajtime të Palës tjetër, shumën e tërësishme të kompensimit, të paguar nga Byroja për Trajtime e palës tjetër, në lidhje me kërkesën për kompensimin e dëmit, sipas përkufizimeve të MOU, shpenzimet e trajtimit si dhe të gjitha shpenzimet e tjera të shkaktuara gjatë trajtimit të asaj kërkesë për kompensim, siç paraqitet në paragrafin 2 dhe 3 në vijim.

2. Tarifat e trajtimit të Byrosë për Trajtime, llogariten sipas përpjesës 15% të shumës totale të kompensimit, me kusht që tarifa minimale e trajtimit të jetë 200.00, Euro, ndërsa ajo maksimale 3,500.00 Euro.

3. Shpenzimet e tjera që paraqiten gjatë trajtimit të dëmit, të përfshira në shpenzimet e trajtimit, do të paguhen në pajtim me procedurat e Marrëveshjes Uniforme të Këshillit të Byrove. Tarifa minimale e trajtimit duhet të llogaritet edhe atëherë kur kërkesa për zhdëmtim është zgjidhur pa u paguar pala e tretë.

4. Gjatë këmbimit të Euros dhe Denarit të R. e Maqedonisë, për të gjitha pagesat në pajtim me këtë MOU, do të mirret parasysh kursi zyrtar i këmbimit i caktuar nga Banka Nacionale e Maqedonisë, në ditën kur kërkesa për kompensim nga Byroja për Trajtime i është dërguar Byrosë për Pagesa.

5. Pas kompletimit të trajtimit të kërkesës për zhdëmtim, dhe sigurimit të "Formularit të pagesës" nga ana e paraqitësit të kërkesës, me të cilën vërtetohet trajtimi i plotë dhe përfundimtar apo aprovohet pajtueshmëria për trajtimin e pjesës jokontestuese të kërkesës si dhe kur ekzekutohet pagesa e kërkesës për zhdëmtim:

(a) Për kërkesat për zhdëmtim që janë si rrjedhojë e aksidenteve në R. e Maqedonisë dhe trajtohen nga Anëtari Sigurues i NIB, anëtari i cili mirret me trajtimin e kërkesës për zhdëmtim, duhet të njoftoj drejtpërdrejt BKS-në, në lidhje me procesimin dhe pagesën e kërkesës për zhdëmtim, së bashku me llogaritjen e dëmit për secilin rast, siç parashihet me Nenin III.4, më lart.

BKS, menjëherë pas pranimit të kërkesës për kompensim, dhe pa vonesë, brenda afatit prej 60 ditësh, nga data e pranimit të kërkesës, duhet t'ia paguaj kompensimin Anëtarit Sigurues të NIB.



Në rast se BKS, në afat prej 60 ditësh, nga data kur përherë të parë i është paraqitur kërkesa për kompensim, nuk i kryen obligimet e veta ndaj Anëtarit Sigurues të NIB, me marrjen e vërejtjes nga Byroja për Trajtime, për mospagesë, BKS duhet të ekzekutoj pagesën në afat prej 30 ditësh, nga data e pranimit të vërejtjes.

Nëse kompensimi nuk kryhet brenda 60 ditësh nga data kur për herë të parë është paraqitur kërkesa për kompensim, BKS do të paguaj kamatën gjobitëse në shkallë prej 12% në vit, të llogaritur nga data kur përherë të parë është paraqitur kërkesa e tillë deri në ditën kur është lejuar pagesa nga Byroja për Trajtime

(B) Në lidhje me kërkesat për zhdëmtim me rastin e aksidenteve në Kosovë, Organizata për Trajtimin e Dëmeve do t'a njoftoj Anëtarin Sigurues të NIB rreth procesimit të kërkesës dhe pagesën e palës së dëmtuar nëpërmes Fondit Garantues së bashku me llogaritjen e dëmit për secilin rast, siç parashihet në Nenin III.4, më lart.

Anëtari Sigurues i NIB, menjëherë pas pranimit të kërkesës për kompensim, pa ndonjë vonesë, duhet që brenda afatit prej 60 ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës, t'ia paguaj BKS-së shumën kompensuese.

Nëse brenda periudhës prej 60 ditësh nga data kur për herë të parë është paraqitur kërkesa për kompensim, Anëtari Sigurues i NIB nuk ka kryer obligimin e pagesës ndaj BKS-së, NIB me pranimin e vërejtjes për një mospërbushje të tillë nga BKS, duhet të paguaj kompensimin, brenda afatit prej 30 ditësh nga data e pranimit të një vërejtjeje të tillë.

Nëse kërkesa për rimbursim nuk zgjidhet brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve, filluar nga data kur kur për herë të parë është paraqitur kërkesa për kompensim, NIB do të paguaj kamatën gjobitëse në shkallë prej 12% në vit, të llogaritur në baza ditore, duke filluar nga data kur përherë të parë është paraqitur kërkesa e tillë deri në ditën kur është bërë lejimi për pagesë nga Byroja për Trajtime.

6. Anëtarët Sigurues të NIB duhet të përpiqen që në mënyrë paqësore dhe me marrëveshje miqësore reciproke të zgjidhin të gjitha kontestet në mes tyre. Në rast të mosmarrëveshjes ndërmjet Byrove, do të themelohet Arbitrazha, si organi i posaçëm në përbërje të tre anëtarëve, vendimi i të cilëve do të jetë i obligueshëm për të dy palët.

Çfardo dallimi në mes të dy palëve që ka të bëjë me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj MOU do të zgjidhet në mënyrë miqësore nga palët në fjalë, me anë të procedurave të mbështetura reciprokisht.



## V. FONDI GARANTUES

1. Secila palë pajtohet që në baza të reciprocitetit, në rast të dëmtimit apo humbjes që mbulohet nga Fondi i Garantues i tyre, t'u siguroj mbrojtje dhe mbështetje të njëjtë, personave që janë me banim të përhershëm në territorin e palës tjetër ashtu siç u siguron personave me banim të përhershëm në territorin e vetë.
2. Personat që janë banorë të Kosovës të cilët bartin dëmtimin apo humbjen sipas paragrafit 1 më lartë, gjatë qëndrimit në territorin e R. e Maqedonisë, kanë të drejtë që t'ia paraqesin kërkesën për zhdëmtim Fondit Garantues të administruar nga NIB, sipas të njëjtave kushte që vlejné për banorët e R. të Maqedonisë. Personat që janë banorë të R. e Maqedonisë, të cilët bartin dëmtimin apo humbjen sipas paragrafit 1 më lartë, gjatë qëndrimit në territorin e Kosovës, kanë të drejtë që t'ia paraqesin kërkesën për zhdëmtim Fondit Garantues të administruar nga BKS, sipas të njëjtave kushte që vlejné për banorët e Kosovës.

## VI. HYRJA NË FUQI DHE SHKËPUTJA E MOU-SË

1. Kjo MOU do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga dy palët dhe do të aplikohet nga data 01.01.2013.
2. Kjo MOU do të jetë në fuqi në kohëzgjatje të pacaktuar. Secila pale mund të kërkojë shkëputjen e kësaj MOU duke dhënë njoftimin me shkrim për shkëputje brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditëve palës tjetër. Kur njoftimi me shkrim është dërguar me shkrim përmes postës, do të merret se është dërguar në të njëjtën date që njoftimi është dërguar sipas verifikimit zyrtar të vulës postare.
3. Kërkesat për zhdëmtim me rastin e aksidenteve të cilat kanë ndodhur gjatë kohës kur ky Memorandum i Mirëkuptimit ka qenë në fuqi, do të trajtohen dhe do të paguhen në pajtim me kriteret dhe dispozitat e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit (MOU), edhe në ato raste kur kërkesat e palës për zhdëmtim janë dërguar pas datës së shkëputjes së këtij Memorandumi të Mirëkuptimit.
4. Në lidhje me çështjet të cilat nuk janë të rreguluara me këtë Memorandum të Mirëkuptimit, do të aplikohen dispozitat e Rregullores së Brendshme.

## VII. MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA

1. Monitorimi dhe mbikëqyrja e implementimit të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit do të bëhet nga organet e autorizuara në pajtim me rregullimet ligjore të




shteteve, sikurse: Agjensioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Maqedoni dhe Banka Qendrore e Kosovës (CBK).

2. Në rast të mosmarrëveshjes ndërmjet Byrove dhe pajtimit për të njëjtën përfaqësuesit e Agjensionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë dhe Banka Qendrore e Kosovës (CBK) do të përfshihen, para se të fillojë procedura e arbitrazhit.

E nënshkruar në Ohër më 24 Tetor 2012, në dy kopje origjinale në gjuhën Angleze, dy kopje origjinale në gjuhën Maqedonase dhe dy kopje origjinale në gjuhën Shqipe. Në rast të mospërputhjes ndërmjet teksteve, ai anglez do të mbizotëroj.

Për:


Byronë Nationale të Republikës  
Së Maqedonisë (NIB)

  
\_\_\_\_\_  
Jonec Popovski  
Drejtor



Për:

Byronë Kosovare të Sigurimit (BKS)

  
\_\_\_\_\_  
Faton Abazi  
Drejtor Ekzekutiv

